VENDIM
Nr. 543, datë 19.8.2014

PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 542, DATË 15.8.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KONTRIBUTIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË IRAKUT, NË KUADËR TË PËRPJEKJEVE TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT", SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 987, DATË 1.12.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE. "PËR KONTRIBUTIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR QEVERINË AFGANE, NË KUADËR TË PËRPJEKJEVE TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 14, të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 542, datë 15.8.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

a) Pas nënndarjes 6 shtohet nënndarja 7:

7.	Automatik 7.62 mm, model 56	Copë	10 000

b) Në fund të tabelës, fjalia "Tabela mbaron me numrin rendor 6 (gjashtë)", zëvendësohet me "Tabela me numrin rendor 7 (shtatë).".

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama